2. **Vlerësimi i Propozimeve Ekonomik kryhet sipas formulës së mëposhtme:**

Pe- Pikët për Propozimin Ekonomik
Çu- Çmimi më i Ulët i Ofruar
Ç – Çmimi Ofertues i Radhës *(duke filluar nga çmimi më i ulët)*

**Pe = 100 x Çu / Ç**
(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

**Vlerësimi përfundimtar**

Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si më poshtë:

**Pesha për Propozimin Teknik: X = (pikët e propozimit teknik x 0.8)**

**Pesha për Propozimin Ekonomik: Y = (pikët e propozimit ekonomik x 0.2)**

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

**Oferta më e mirë = X + Y**

Operatori ekonomik që ka marrë më shumë pikë gjatë mbledhjes së pikëve teknike dhe ekonomike do të ftohet për negociata dhe lidhjen e kontratës.

**22. Korrigjimi i gabimeve**

Autoriteti/Enti Kontraktor kontrollon propozimet ekonomike të paraqitura nëse kanë gabime arithmetike. Nëse propozimet rezultojnë me gabime arithmetike, autoriteti/enti i korrigjon këto gabime si më poshtë:

**arithmetike**

**(a)** Nëse ka një mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit për njësi me sasinë, çmimi për njësi do të mbizotërojë dhe çmimi total do të ndryshohet përkatësisht.

**(b)** Nëse ka ndonjë mospërputhje në çmimin total, kur totali është shuma ose diferenca e nën-totaleve, çmimi nën-total mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet bazuar në të.

**(c)** Nëse ka ndonjë mospërputhje midis fjalëve dhe numrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë. Përjashtim nga ky rregull është situata kur shuma ka të bëjë me gabimin, i cili do të korrigjohet sipas pikave (a) dhe (b) më lart, prandaj në këtë rast shuma në numër mbizotëron dhe ajo me fjalë do të korrigjohet.

**(d)** Nëse ekziston një mospërputhje midis fjalëve dhe shifrave, shuma me fjalë do të mbizotërojë, përveç nëse shuma e shprehur me fjalë lidhet me një gabim aritmetik, rast në të cilin shuma në shifra do të mbizotërojë në bazë të (a) dhe (b) më sipër.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- vlera absolute e të gjitha korrigjimeve është më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- vlera absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por korrigjimi nuk pranohet nga ofertuesi.

**23. Krahasimi i propozimeve**

Autoriteti/Enti Kontraktor rendit propozimet sipas rezultateve teknike e financiare të kombinuara, duke përdorur peshën e treguar në Dokumentat e Tenderit. Në përfundim të afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor fillon bisedimet me fituesin për të sqaruar dhe për të përmirësuar kushtet e kontratës, metodologjinë, përbërjen e stafit dhe kushtet e veçanta. Bisedimet nuk duhet t’i ndryshojnë në mënyrë thelbësore kushtet fillestare të kontratës ose propozimin e përzgjedhur.

Oferta ekonomike nuk duhet të ndryshohet në asnjë rast.

**24. Konvertimi në valutë të vetme**

1. Për qëllime vlerësimi dhe krahasimi, monedha (et) e Ofertës do të konvertohet në një monedhë të vetme siç specifikohet në Njoftimin e kontratës.

## G. DHËNIA E KONTRATËS

**25.Njoftimi i Fituesit**

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Propozimit, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Propozimi i tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

**26. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës**

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve, Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen Kuadër/Kontratën.
2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

a) garanci bankare

b) garanci nga shoqëri sigurimi.

## H. ANKESAT

**27. Procedura e ankesës**

1. Cdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t’i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

## I. ANULIMI I PROCEDURËS

**28. Anulimi i procedurës**

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen

e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 te LPP dhe nenin 75 te VKM 285/2021.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Kërkesë për pjesëmarrje
Shtojca 2: Ftesa për Propozim
Shtojca 3: Formulari i Deklarimit të Propozimit
Shtojca 4: Formulari i Propozimit Ekonomik
Shtojca 5: Formulari i Sigurimit të Ofertës
Shtojca 6: Lista e Informacionit Konfidencial
Shtojca 7: Deklaratë për disponueshmërinë e stafit të konsulentit
Shtojca 8: Formulari i Specifikimeve Teknike
Shtojca 9: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit
Shtojca 10: Formulari i Termave të Referencës
Shtojca 11: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes se Ofertuesve
Shtojca 12: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit
Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të skualifikimit
Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraprak)
Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraprak)
Shtojca 17: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

**Shtojca 1**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik*]

**KËRKESË PËR PJESËMARRJE**

____________________________

*(Emri i operatorit ekonomik dhe NIPT-i)*

*[Data______]*

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës]*
Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*
Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]*

Unë (Ne), të nënshkruarit, paraqesim kërkesën tonë për pjesëmarrje për këtë procedurë:

**Emri i Përfaqësuesit të Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Datë**

**Shtojca 2**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga autoriteti/enti kontraktor*]

**FTESË PËR PROPOZIM**

*(Vetëm për kandidatët e përzgjedhur pas shqyrtimit të kërkesave për pjesëmarrje)*

[Data]

Për : *[Emri dhe adresa e ofertuesit të përzgjedhur]*

__________________________________

**Procedura e Prokurimit**: _______________________________

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, ju informojmë se *[emri dhe adresa e kandidatit të përzgjedhur]*, pas vlerësimit të dokumentave të paraqitura në fazën e pare, jeni kualifikuar për në fazën e e paraqitjes së propozimeve.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **________________________________**(*emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor)*

propozimin tuaj, duke marrë parasysh se:

**Afati kohor për dorëzimin dhe hapjen e propozimit është :**

**Data, ora dhe adresa**

Data: □□/□□/□□□□*(d/m/v)* **ora** □□:**_**□□

Adresa: ________________________________________

**Kur propozimi kërkohet të paraqitet në mënyrë elektronike, operatorët ekonomikë duhet të dorëzojnë propozimin në mënyrë elektronike në faqen zyrtare të APP-së, ëëë.app.gov.al**

**Informacioni mbi propozimet e paraqitura me mjete elektronike, i transmetohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar propozime, në bazë të kërkesës së tyre.**

**Gjuha(-ët) për hartimin e propozimeve janë:**

Shqip ☐ Anglisht ☐

**Kriteret e përzgjedhjes së fituesit :**

Autoriteti/Enti Kontraktor rendit propozimet sipas rezultateve teknike e financiare të kombinuara, duke përdorur peshën e treguar në Dokumentat e Tenderit. Ofertuesi që arrin rezultatin më të lartë të kombinuar teknik e financiar do të ftohet për negociata për lidhjen e kontratës.

Jemi në pritje të propozimit tuaj.

**Titullari i Autoritetit/Entit Kontraktor**

**Shtojca 3**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik*]

**FORMULARI I DEKLARIMIT TË PROPOZIMIT**

*[Data______]*

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*

Procedura e prokurimit: *[lloji i procedurës]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/ Nr. Referencës në faqen e APP-së*

Emri i operatorit ekonomik dhe NIPT-i

Unë (Ne), të nënshkruarit, deklarojmë se:

**(a)** Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[*shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE*]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.

**(b)** Ne **[*vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti*]**), nuk jemi të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[*vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit*]**.

**(c)** Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me grafikun e kërkuar të kryerjes së shërbimit.

**(d)** Ne nuk marrim pjesë si kandidatë në më shumë se një propozim në këtë procedurë prokurimi.

**(d)** Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:

1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
2. Njoftimin e Kontratës;
3. Kriteret e Përzgjedhjes;
4. Specifikimet teknike dhe termat e referencës;
5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
6. Kushtet e Veçanta të Kontratës.

**e)** Çmimi Total i propozimit tonë është shprehur në propozimin ekonomik.

**Emri i Përfaqësuesit të Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Datë**

**Shtojca 4**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik*]

**FORMULARI I PROPOZIMIT EKONOMIK**

**Tarifat sipas Kategorisë së Punës :** **(**Nëntotali i detajuar)

**Pagesat Ditore:** **(**Nëntotali i detajuar)

**Kostot e Drejtpërdrejta:** **(**Nëntotali i detajuar)

**Shpenzimet e Rimbursueshme:** **(**Nëntotali i detajuar)

**TOTALI**

**Përfaqësuesi i Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shtojca 5**

[ *Shtojcë për t’u paraqitur nga operatori ekonomik)*
[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]*
Në emër të: *[Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]*

* * *

Procedura e prokurimit *[lloji i procedurës]*
Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*
Publikimi *(nëse zbatohet):* Buletini i Njoftimeve Publike *[Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se*

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

*Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra]* si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit/entit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kerkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontrates së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [*njoftimin e kontratës*].

**[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]**

**Shtojca 6**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

**Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

| Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial | Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale | Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni | Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

**Shtojca 7**

[ *Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

**DEKLARATË**
**Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit[2]**

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _________________ nga Autoriteti/Enti Kontraktor________________ me objekt ____________ me fond limit __________.

Në bazë të parashikimeve të neneve 41 dhe 54 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", Unë i nënshkruari _____________________, në cilësinë e anëtarit të stafit të Konsulentit "..............................................." për procedurën e prokurimit me objekt______________ nën përgjegjësinë time personale, ***Deklaroj*** se:

1. Autorizoj VETËM Konsulentin "…………………………………..." të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _________________ nga Autoriteti/Enti Kontraktor________________ me objekt ____________ me fond limit __________.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo konsulenti tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt ……………………………………………………….,  është i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

3. Nuk ndodhem në kushtet e konfliktit të interesit, ***me asnjë*** nga anëtarët e stafit të autoritetit/entit kontraktor, drejtpërdrejtë ose jo, i përfshirë në ndonjë pjesë të përgatitjes së kushteve të kontratës dhe/ose në procesin e përzgjedhjes për këtë kontratë dhe/ose për mbikëqyrjen e kësaj kontrate.

Data e dorëzimit të deklaratës ________________

**Emri, Mbiemri, Nënshkrimi**

Vula

[2] Kjo deklaratë duhet të nënshkruhet nga seicili prej anëtarëve të stafit të konsulentit dhe do të jetë pjesë e dokumentave të ofertës së konsulentit.

**Shtojca 8**

[ *Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

## FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

**Referuar Termave te Referencës bashkëngjitur DST**

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent”.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

**Shtojca 9**

(*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)*

*(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit*)

## FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: **”Për miratimin e Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë e Strategjitë për zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030 në Nivel Lokal”**

Afati i marreveshjes Kuader :12 muaj kalendarike

**Afatet e ekzekutimit:**

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | |
| | | | | |

**Shtojca 10**

[ *Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

## FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: ”**Për miratimin e Vlerësimit të Riskut nga Fatkeqësitë e Strategjitë për zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030 në Nivel Lokal”**

## 1. FJALORI I TERMAVE[3]

| | |
|---|---|
| Ndërtoni më mirë (Build Back Better) | Përdorimi i fazave të rimëkëmbjes, rehabilitimit dhe rindërtimit pas një katastrofe për të rritur qëndrueshmërinë e komuniteteve përmes integrimit të masave për zvogelimin e riskut të fatkeqësive në rindertimin e infrastrukturës fizike dhe sistemeve shoqërore, si dhe në rigjallërimin e mjeteve të jetesës, ekonomive dhe mjedisit. |
| Kapacitet | Kombinimi i të gjitha fuqive, atributeve dhe burimeve të disponueshme brenda një komuniteti, shoqërie ose organizate për të menaxhuar dhe reduktuar risqet dhe për të forcuar elasticitetin. |
| Emergjencë Civile | Situata e papritur me pasoja negative për komunitetin dhe që cenon sigurinë e tij, e cila shkaktohet nga fatkeqësitë që sjellin dëme të menjëhershme e të rënda për jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin. |
| Plani për Emergjencat Civile | Plani për përgatitjen, parandalimin, mbrojtjen, shpëtimin dhe ndihmën në rast të një fatkeqësie natyrore ose të një fatkeqësie tjetër, i hartuar në bazë të vlerësimit të risqeve dhe të gjetjeve të ekspertëve. |
| Mbrojtja Civile | Tërësia e masave të marra për parashikimin, parandalimin, lehtësimin, gatishmërinë, përgjigjen dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera, me qëllim mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, |

[3] Për përcaktimet, janë përdorur si referencë terminologjia e UNDRR dhe Ligji 45/2019 “Për mbrojtjen civile”.

| | |
|---|---|
| | të pronës, të trashëgimisë kulturore dhe të mjedisit. |
| Kapacitet Përballues | Aftësia e njerëzve, organizatave dhe sistemeve që përdorin aftësitë dhe burimet e disponueshme, për të përballuar dhe menaxhuar kushtet e pafavorshme, emergjencat apo fatkeqësitë. |
| Kriza | Një situatë e sigurisë në një zonë të caktuar e më gjerë, e cila nuk mund të kontrollohet me burime dhe masa të zakonshme, në të cilën kërcënohen vlerat themelore të shoqërisë për shkaqe ushtarake, ekonomike, sociale dhe politike, të cilat mund të kapërcejë kufijtë shtetërorë dhe përbëjnë kërcënim të menjëhershëm për vendet e tjera. |
| Infrastrukturë kritike | Strukturat fizike, objektet, rrjetet dhe pasuritë e tjera të cilat janë thelbësore për funksionimin social dhe ekonomik të një shoqërie ose komuniteti. |
| Fatkeqësi | Një ndërprerje serioze e funksionimit të një komuniteti ose shoqërie, në çfarëdolloj shkalle, për shkak të ngjarjeve të rrezikshme që ndërveprojnë me kushtet e ekspozimit, cenueshmërisë dhe kapacitetit, duke çuar në një ose më shumë nga sa vijon: humbje dhe ndikime njerëzore, materiale, ekonomike dhe mjedisore. |
| Impakti i fatkeqësisë | Efekti total, duke përfshirë efektet negative (p.sh. humbjet ekonomike) dhe efektet pozitive (p.sh. fitimet ekonomike), të një ngjarjeje të rrezikshme ose të një fatkeqësie. Termi përfshin impaktet ekonomike, njerëzore dhe mjedisore dhe mund të përfshijë vdekje, plagosje, sëmundje dhe efekte të tjera negative për shëndetin fizik, mendor dhe mirëqënien sociale të njeriut. |
| Baza e të dhënave të humbjes nga fatkeqësitë | Një grup të dhënash të mbledhura në mënyrë sistematike për ndodhjen e fatkeqësive, dëmet, humbjet dhe impaktet, në mënyrë ideale në përputhje me kërkesat minimale të monitorimit të Kuadrit Sendai. |
| Menaxhimi i fatkeqësive | Organizimi, planifikimi dhe zbatimi i masave të përgatitjes, përgjigjes dhe rimëkëmbjes prej fatkeqësive. |
| Informacioni për riskun e fatkeqësive | Informacioni gjithëpërfshirës mbi të gjitha dimensionet e riskut të fatkeqësitë, duke përfshirë rreziqet, ekspozimin, cenueshmërinë dhe kapacitetin lidhur me personat, komunitetet, organizatat dhe vendet, dhe asetet e tyre. |
| Menaxhimi i riskut nga fatkeqësitë | Zbatimi i politikave dhe strategjive për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë për të parandaluar riskun e ri të fatkeqësive, për të zvogëluar riskun ekzistues të fatkeqësive dhe për të menaxhuar riskun e mbetur, duke kontribuar në forcimin e aftësisë ripërtëritëse dhe zvogëlimin e humbjeve nga fatkeqësitë. |
| Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë | Ka qëllim parandalimin e riskut të ri të fatkeqësive, zvogëlimin e riskut ekzistues të fatkeqësive dhe menaxhimin e riskut të mbetur, të gjitha këto kontribuojnë në forcimin e aftësisë ripërtëritëse dhe si rezultat në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm. |
| Sistemi i paralajmërimit të | Një sistem i integruar i monitorimit të rrezikut, prognozës dhe parashikimit, vlerësimit të riskut të fatkeqësive, sistemeve dhe proceseve të aktiviteteve të |

| | |
|---|---|
| hershëm | përgatitjes dhe të komunikimit, që u mundësojnë individëve, komuniteteve, qeverive, subjekteve dhe të tjerëve që të ndërmarrin veprime në kohë për të zvogëluar risqet e fatkeqësive përpara ngjarjeve të rrezikshme. |
| Menaxhimi i emergjencave | Organizimi dhe menaxhimi i burimeve dhe përgjegjësive për trajtimin e të gjitha aspekteve të emergjencave, në veçanti të gatishmërisë, përgjigjes dhe hapave fillestarë të rimëkëmbjes. |
| Ekspozimi | Njerëzit, infrastruktura, banesat, kapacitetet prodhuese dhe asetet e tjera të prekshme njerëzore të vendosura në zona të rrezikuara. |
| Parashikim | Deklaratë e caktuar ose vlerësim statistikor i ndodhjes së mundshme të një ngjarjeje të ardhshme të rrezikshme apo kushteve për një zonë të caktuar. |
| Rrezik | Një proces, fenomen ose aktivitet njerëzor, që mund të shkaktojë humbje të jetës, plagosje apo impakte të tjera shëndetësore, dëmtim të pronës, ndërprerje të veprimtarisë sociale dhe ekonomike ose degradim mjedisor. |
| Zbutje | Zvogëlimi ose minimizimi i ndikimeve negative të një ngjarjeje të rrezikshme. |
| Fatkeqësi natyrore | Fatkeqësitë që shkaktohen nga dukuri natyrore ekstreme, që lidhen me tërmetet, përmbytjet dhe vërshimet e ujit, temperaturat ekstreme dhe të vazhdueshme, rrëshqitjet arkitektonike, ortekët, erërat e forta në det dhe tokë, zjarret masive në pyje, sëmundjet infektive masive dhe dukuri të tjera që ndikojnë në jetën e njerëzve, gjënë e gjallë, pronën, trashëgiminë kulturore dhe mjedisin. |
| Rrezik natyror | Një proces apo fenomen natyror që mund të shkaktojë humbje të jetës, plagosje apo impakte të tjera shëndetësore, dëmtim të pronës, humbje të mjeteve të jetesës dhe shërbimeve, ndërprerje të veprimtarisë sociale dhe ekonomike ose dëmtim mjedisor. |
| Masa jo strukturore | Masat që nuk përfshijnë ndërtimine fizik, të cilat përdorin njohuritë, praktikën ose marrëveshje për të zvogëluar risqet dhe impaktet e fatkeqësive, veçanërisht përmes politikave dhe ligjeve, ngritjes së ndërgjegjësimit publik, trajnimit dhe edukimit. |
| Parandalimi | Aktivitetet dhe masat për të shmangur risqet e fatkeqësive ekzistuese dhe atyre të reja. |
| Ndërgjegjësimi publik | Përhapja e njohurive të zakonshme në lidhje me risqet nga fatkeqësitë, e faktorëve që çojnë në fatkeqësi dhe e veprimeve që mund të ndërmerren individualisht dhe kolektivisht për të zvogëluar ekspozimin dhe cenueshmërinë ndaj rreziqeve. |
| Gadishmëri | Njohuritë dhe kapacitetet e zhvilluara nga qeveritë, organizatat profesionale të përgjigjes dhe rimëkëmbjes, komunitetet dhe individët për të parashikuar, për t’iu përgjigjur dhe për t’u rimëkëmbur në mënyrë efektive nga impaktet e |

| | |
|---|---|
| | fatkeqësive të mundshme, të afërta apo reale. |
| Rimëkëmbja | Rivendosja ose përmirësimi i mjeteve të jetesës dhe të shëndetit, si dhe i aseteve ekonomike, fizike, sociale, kulturore dhe mjedisore, sistemeve dhe aktiviteteve të një komuniteti ose shoqërie të prekur nga fatkeqësitë, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm dhe të konceptit "ndërto përsëri më mirë", për të shmangur ose zvogëluar riskun e fatkeqësive të ardhshme. |
| Rehabilitimi | Rivendosja e shërbimeve dhe e strukturave bazë për funksionimin e një komuniteti ose një shoqërie të prekur nga një fatkeqësi. |
| Risku i mbetur | Risku i fatkeqësisë që mbetet në formë të pamenaxhuar, edhe kur ekzistojnë masa të efektshme për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, dhe për të cilin duhet të disponohen kapacitetet e përgjigjes emergjente dhe të rimëkëmbjes. |
| Aftësia ripërtëritëse | Aftësia e një sistemi, komuniteti ose shoqërie të ekspozuar ndaj rreziqeve, për të rezistuar, thithur, akomoduar, për t’u përshtatur, transformuar dhe për t’u rimëkëmbur nga efektet e një rreziku në kohën e duhur dhe në mënyrë efikase, duke përfshirë ruajtjen dhe restaurimin e strukturave dhe funksioneve të tij thelbësore themelore nëpërmjet menaxhimit të riskut. |
| Përgjigje | Veprimet e ndërmarra drejtpërdrejt para, gjatë ose menjëherë pas një fatkeqësie për të shpëtuar jetë, për të zvogëluar impaktin në shëndet, për të garantuar sigurinë publike dhe për të përmbushur nevojat themelore të njerëzve të prekur. |
| Risku | Kombinimi i mundësisë së ndodhjes së një ngjarjeje dhe të pasojave të saj negative. |
| Vlerësimi i riskut | Një qasje cilësore ose sasiore për të përcaktuar natyrën dhe shtrirjen e riskut nga fatkeqësitë duke analizuar rreziqet e mundshme dhe duke vlerësuar kushtet ekzistuese të ekspozimit dhe cenueshmërisë, që së bashku mund të dëmtojnë njerëzit, pronën, shërbimet, mjetet e jetesës dhe mjedisin nga i cili ato varen. |
| Masat strukturore | Çdo ndërtim fizik për të zvogëluar ose shmangur impaktet e mundshme të rreziqeve, ose aplikimi i teknikave apo teknologjisë inxhinierike për të arritur rezistencën ndaj rrezikut dhe aftësinë ripërtëritëse në struktura ose sisteme. |
| Cënueshmëria | Kushtet e përcaktuara nga faktorë ose procese fizike, sociale, ekonomike dhe mjedisore, të cilat rrisin ndjeshmërinë e një individi, një komuniteti, pasurie apo sistemeve ndaj impakteve të rreziqeve. |

## 1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Shqipëria është një vend i prirur ndaj fatkeqësive. Ndër rreziqet kryesore që prekin vendin janë tërmetet, përmbytjet, zjarret në pyje, rrëshqitjet e dheut, aksidentetet teknologjike/industriale, sËmundjet infektive etj. Baza e të dhënave Ndërkombëtare të Fatkeqësive (EM-DAT) tregon se, gjatë periudhës 1979-2019, përmbytjet përbënin një pjesë të konsiderueshme të ngjarjeve të fatkeqësive (38%), të ndjekura nga tërmetet (15%). Sipas raportit vjetor të rrezikut botëror (BEH-IFHV, 2021), i cili llogarit Indeksin e Rrezikut të Fatkeqësive për shkak të tërmeteve, cikloneve, përmbytjeve, thatësirave dhe rritjes së nivelit të detit për 181 vende bazuar në ekspozimin dhe cenueshmërinë (ndjeshmërinë dhe përballimin, dhe kapacitetet adaptive), Shqipëria ka një indeks me rrezikshmëri të lartë dhe renditet e para në Evropë dhe e 61-ta në botë[4]. Humbjet e mundshme në Shqipëri nga një fatkeqësi me një periudhë mesatare kthimi 250-vjeçare vlerësohen në 2.08 miliardë euro për tërmetet dhe 1.18 miliardë euro për përmbytjet (Banka Botërore, 2014).

Niveli i ekspozimit ndaj rreziqeve dhe dobësive në Shqipëri është për shkak të një kombinimi të proceseve socio-ekonomike dhe mjedisore dhe kontekstit institucional dhe politik. Krahas rreziqeve të fatkeqësive natyrore në territorin e Shqipërisë, rritja e cenueshmërisë së komunitetit është një faktor që kontribuon ndjeshëm në riskun e përgjithshëm dhe mundësinë e fatkeqësive në vend. Tendencat në vijim në Shqipëri kontribuojnë në rritjen e cenueshmërisë.
• Rritja e popullsisë dhe rrjedhimisht rritja e dendësisë së strehimit, si dhe investimi në tokat bujqësore dhe jourbane;
• Zhvendosja nga zonat rurale në ato urbane dhe presioni i urbanizimit, i cili çon në përqendrimin e njerëzve në zona urbane të pasigurta;
• Degradimi i burimeve natyrore (p.sh., mbikullotja e lëndinave dhe mbishfrytëzimi i pyjeve);
• Varfëria ende ekzistuese dhe rritja e numrit të njerëzve të varfër që janë të ekspozuar ndaj rreziqeve;
• Masa të pamjaftueshme në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të fatkeqësive, si dhe teknika të pamjaftueshme të parashikimit dhe parandalimit;
• Mungesa e masave strikte për kontrollin mjedisor;
• Kapacitete të dobëta institucionale dhe burime të pakta për përballimin e fatkeqësive masive;
• Arsimim dhe trajnim i pamjaftueshëm i personelit të mbrojtjes civile dhe popullsisë lidhur me masat e mbrojtjes dhe vetëmbrojtjes.
• Pjesëmarrje e ulët e komuniteteve vendore në menaxhimin e riskut të fatkeqësive

Nga ana tjeter, ngjarja e tërmetit të 26 nëntorit 2019 shkaktoi 51 viktima dhe mbi 900 të plagosur. Si pasojë e tërmetit janë prekur gjithsej 202.291 persona, nga të cilët 47.265 drejtpërdrejt dhe 155.028 tërthorazi. Vlerësimi i nevojave pas katastrofës (PDNA), i kryer pas tërmetit, vlerësoi se efekti i përgjithshëm i fatkeqësisë në 11 bashkitë e prekura arrin në 985

[4] Rezultati i Indeksit Botëror të Riskut për vitin 2021 për Shqipërinë është 8.23%, duke reflektuar një kombinim të ekspozimit “shumë të lartë” dhe cenueshmërisë së ulët (ndjeshmëria “e ulët”, mungesa e kapaciteteve përballuese “mesatare” dhe mungesa e kapaciteteve përshtatëse “të ulëta”).

milionë euro. Tërmeti vlerësohet të ketë shkaktuar dëme dhe humbje të kombinuara, ekuivalente me 7.5% të PBB-së 2019. Në anën "pozitive", tërmeti i 26 nëntorit shkaktoi një reflektim për reduktimin e cenueshmërisë dhe rritjen e elasticitetit në të gjitha nivelet në të ardhmen. Megjithatë, edhe pse ende nën efektin e tërmetit, pandemia COVID-19 e vitit 2020 përbënte një sfidë tjetër si për sistemin shëndetësor të vendit ashtu edhe për qeverinë. Ngjarjet që pasuan theksuan nevojën për të forcuar gatishmërinë ndaj fatkeqësive dhe kapacitetet e menaxhimit të rrezikut, miratimin e sistemeve dhe procedurave adekuate të reagimit dhe përmirësimin e kapacitetit institucional për menaxhimin, koordinimin dhe ndërveprimin midis qeverisë dhe aktorëve privatë dhe të shoqërisë civile.

Nga pikëpamja ligjore, në vitin 2019, Qeveria Shqiptare miratoi Ligjin “Për Mbrojtjen Civile” (45/2019), duke zëvendësuar atë të mëparshëm të vitit 2001. Ligji ofron një kuadër konceptual më solid për nxitjen e reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë. Më tej, parimi i subsidiaritetit të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” është ripërcaktuar sërish në ligjin 45/2019, i cili neni 7 thekson se “kur në fatkeqësi natyrore apo fatkeqësi të tjera, mbrojtja, shpëtimi dhe ndihma janë. të kërkuara, fillimisht do të shfrytëzohen kapacitetet e njësisë së qeverisjes vendore të prekur nga fatkeqësia.” Njekohesisht, krijimi i Agjencisë Kombetare te Mbrojtjes Civile (AKMC), ridimensionoi qeverisjen e fatkeqesive, duke i dhene nje autoritet koordinues, teknik dhe monitorues ne fushen e zvogelimit te riskut te fatkeqesive nga nje rol reaktiv ne nje rol proaktiv.

Ligji 45/2019 parashikon përgjegjësi më të gjera dhe të qarta të ZRF për nivelin vendor lidhur me ndërgjegjësimin e publikut, aktivitetet trajnuese, monitorimin, paralajmërimin e hershëm, alarmin dhe alarmin, informacionin për rrezikun e fatkeqësive, bazën e të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë, etj. Për më tepër, për të realizuar të gjitha këto detyrime, Ligji kërkon shprehimisht që një shumë prej jo më pak se 4% e buxhetit total të bashkisë t'i dedikohet ZRF-së dhe Mbrojtjes Civile.

## 2. NGRITJA E KORNIZËS SË ZVOGËLIMIT TË RISKUT NGA FATKEQËSITË (ZRF)

Ligji 45/2019, në përputhje me angazhimet e Kuadrit Sendai, kërkon përgatitjen e Vlerësimeve të Riskut të Fatkeqësive në nivel kombëtar dhe lokal brenda dy viteve nga miratimi i ligjit. Ai gjithashtu kërkon përgatitjen dhe miratimin e një Strategjie Kombëtare të ZRF-së dhe Strategjive lokale të ZRF-së dhe një Plani Kombëtar të Emergjencave Civile dhe Planeve Lokale të Emergjencave.

Sipas nenit 9 të ligjit: “Vlerësimi i riskut kryhet në nivel qendror, qarkor dhe vendor të paktën çdo tre vjet. Vlerësimi i riskut në nivel bashkie miratohet me vendim të Këshillit Bashkiak.” Më tej, neni 30 thekson se: “Bashkitë duhet të kryejnë vlerësimin e riskut në territorin e tyre duke hartuar dhe miratuar dokumentin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë, të cilin ia paraqesin Prefektit të Qarkut dhe AKMC-së për analiza dhe planifikim brenda dy viteve. nga hyrja në fuqi e këtij ligji”. Në këtë aspekt, duhet të ketë harmonizim të vlerësimit të rrezikut

në nivele. Niveli lokal mund të përmbajë gjithashtu rreziqe lokale të rëndësishme për nivelin lokal, por jo të mundshme për nivelin qendror.

Sipas nenit 11 të ligjit, “çdo njësi e vetëqeverisjes vendore me vendim të këshillit bashkiak të paktën çdo pesë vjet miraton strategjinë vendore të ZRF-së, të harmonizuar me Strategjinë Kombëtare të ZRF-së”.

Sipas nenit 14 të ligjit: “Planet e emergjencës civile miratohen në nivel qendror, qarku dhe vendor dhe rishikohen të paktën çdo tre vjet. Plani EC i bashkisë miratohet me vendim të këshillit bashkiak. Ai duhet të harmonizohet me PKEC-në, planin EC të qarkut dhe planet EC bashkiake të bashkive fqinje.” Ajo që është specifike për planet e EC bashkiake është se “krijimi dhe zbatimi i metodologjisë së zhvillimit të planeve të emergjencës civile” është detyrim ligjor i AKMC.

Kështu, për sa më sipër, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile ka drejtuar prej mëse nje viti procesin e hartimit te dokumentave strategjike dhe planifikues kombetarë. Kështu me VKM nr. 168, datë 24.03.2023 është miratuar dokumenti i “Vleresimit të Riskut nga Fatkeqësitë në nivel qendror” dhe me VKM nr. 94, datë 22.02.2023 është miratuar “Strategjia Kombëtare e Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030”. Në këtë kuadër është plotësuar baza metodologjike për replikimin e këtyre dokumentave në nivel local, me qëllim përmbushjen e detyrimit ligjor.

## 3. OBJEKTIVI I TENDERIT

Objektivi i shërbimeve aktuale të kërkuara është të mbështesë rregullimin e saktë të kuadrit lokal të ZRF-së në funksion të detyrimit ligjor për të gjitha bashkitë për të zhvilluar kuadrin e tyre të ZRF, në harmonizim dhe koordinim me dokumentat në nivelin qendror. Më herët ky proces është pilotuar në gjashtë bashkitë e Qarkut Fier, metodologjia e të cilës do të shërbejë gjithashtu si referencë për Bashkinë Tiranë.

Besohet se ky ushtrim do të kontribuojë në vendosjen e një standardi bashkiak që do të ndiqet dhe përsëritet më tej në bashkitë e tjera shqiptare. Ky proces do të zhvillohet paralelisht me bashkërendimin dhe monitorimin e autoriteteve të Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC) për të garantuar gjithëpërfshirje administrative dhe teknike.

## 4. QËLLIMI I SHËRBIMIT

Ky shërbim konsulence konsiston në dy faza:

1. Hartimi i Vlerësimit të Riskut të Fatkeqësive në nivel lokal per Bashkinë Tiranë.
2. Hartimi i Strategjisë Vendore të ZRF-së për Bashkinë Tiranë,

Mbështetja specifike aktuale për nivelin lokal do të ketë tre përfitime të menjëhershme:

- së pari, proceset pjesëmarrëse për zhvillimin e vlerësimit të rrezikut lokal dhe strategjisë së ZRF-së do të shërbejnë si ushtrime të fuqishme ndërgjegjësuese për institucionet dhe komunitetet lokale.

- së dyti, dokumentet e përmendura më sipër do të ushqehen me njëri-tjetrin si dhe do të ndërveprojnë me dokumentet e nivelit qarkor dhe kombëtar (pritet ndërveprim dhe ndikim nga lart-poshtë dhe poshtë-lart); dhe

- së treti, dokumentet e reja kombëtare, pavarësisht përditësimit të tyre, do të bazohen në kuadrin aktual të ZRF-së me një përafrim të fortë me Kornizën Sendai, të cilat janë parimet që duhen ndjekur edhe për dokumentet vendore.

## 4.1 Vlerësimi i Riskut të Fatkeqësive në nivel Lokal-Bashkiak

Vlerësimi i Riskut bashkiak është hapi i parë i rëndësishëm në kuadrin lokal të ZRF-së pasi ndihmon të:

- ✓ Kuptoni situatën aktuale lokale, nevojat dhe mangësitë duke ndërtuar mbi informacionin dhe kapacitetet ekzistuese.
- ✓ Identifikoni rreziqet e mundshme, dobësitë, ekspozimin dhe kapacitetin përballues të komuniteteve.
- ✓ Të kuptojnë natyrën, vendndodhjen, intensitetin dhe gjasat e rreziqeve të mëdha specifike për territorin.
- ✓ Vlerësoni probabilitetin e shfaqjes dhe dëmin e mundshëm për rreziqe specifike.
- ✓ Identifikoni popullsinë dhe pasuritë në rrezik dhe zonat e prirura nga fatkeqësitë.
- ✓ Vlerësoni kapacitetin e elementeve në rrezik për t'i bërë ballë skenarëve të caktuar të rrezikut dhe më pas,
- ✓ Identifikoni opsionet e reduktimit të rrezikut duke marrë parasysh arsyeshmërinë, kosto-efektivitetin, prakticitetin e masave dhe kapaciteteve.
- ✓ Formuloni ose rishikoni strategjitë dhe planet e veprimit për ZRRF bashkiake duke përdorur gjetjet e rreziqeve, rrezikut, ekspozimit dhe vlerësimeve të kapacitetit përballues.

Hapi i parë në Vlerësimin e Riskut është kryerja e një Vlerësimi të plotë të Vulnerabilitetit dhe Kapacitetit (VCA). VCA është një proces hulumtues pjesëmarrës i krijuar për të vlerësuar rreziqet me të cilat përballen njerëzit në lokalitetin e tyre, cenueshmërinë e tyre ndaj këtyre rreziqeve dhe kapacitetet që ata posedojnë për të përballuar një rrezik dhe për të rikuperuar prej tij kur ai godet. Përfundimi i procesit të VCA-së do të sigurojë informacion të konsoliduar përmes "kontrollit të kryqëzuar" dhe krahasimit të burimeve të ndryshme të të dhënave dhe do të përfshijë ushtrimin e Vlerësimit të Riskut. Dokumentet e Vlerësimit të Riskut Lokal do të udhëhiqen nga Dokumenti Kombëtar i Vlerësimit të Riskut dhe do të udhëhiqen nga procesi kombëtar për të siguruar të dhëna të sakta dhe për të ofruar të dhëna të përditësuara për secilin prej profileve të vendeve të rrezikut sipas ligjit 45/2019 për Mbrojtjen Civile.

Për Vlerësimin e Riskut, Ofruesi i Shërbimit do të sigurohet që të ndjekë sekuencën e hapave të mëposhtëm[5]:

**Identifikimi i rrezikut** - procesi i gjetjes, njohjes dhe përshkrimit të rreziqeve. Është një ushtrim kontrolli dhe shërben si një hap paraprak për fazën e mëpasshme të analizës së rrezikut

**Analiza e rrezikut** - procesi për të kuptuar natyrën e rrezikut dhe për të përcaktuar nivelin e rrezikut.

**Vlerësimi i rrezikut** - procesi i krahasimit të rezultateve të analizës së rrezikut me kriteret e rrezikut për të përcaktuar nëse rreziku dhe/ose madhësia e tij është e pranueshme apo e tolerueshme.

Në përgjithësi, skenarët e rrezikut do të përdoren si në fazën e identifikimit të rrezikut ashtu edhe në fazën e analizës së riskut, me këtë të fundit që synon të krijojë vlerësime sasiore për ndikimet dhe probabilitetet. Në fazën e identifikimit të rrezikut, ndërtimi i skenarit duhet të hartohet në mënyrën më gjithëpërfshirëse dhe mund t'i referohet vlerësimeve të përafërta ose analizave cilësore. Në fazën e analizës së rrezikut, nëse është e mundur, duhet të vlerësohen probabilitetet sasiore për secilin skenar. Për qëllime të identifikimit të rrezikut dhe analizës së rrezikut, futen një sërë dallimesh:

**Vlerësimet e një risku** të vetëm përcaktojnë rrezikun e veçantë (d.m.th., gjasat dhe pasojat) nga një rrezik i veçantë (p.sh., përmbytja) ose një lloj i veçantë rreziku (p.sh., përmbytjet) që ndodhin në një zonë të caktuar gjeografike gjatë një periudhe të caktuar kohore.

**Vlerësimi me shumë risqe (multi-risk approach)** përcakton rrezikun total nga disa rreziqe, duke marrë parasysh rreziqet e mundshme dhe ndërveprimet e cenueshmërisë. Sfida e vlerësimeve me shumë rrezik është që të merren parasysh në mënyrë adekuate efektet e mundshme pasuese (të njohura edhe si efekte goditjeje, domino ose kaskadë) midis rreziqeve, d.m.th., situata ku një rrezik shkakton një ose më shumë rreziqe të njëpasnjëshme. Kështu, vlerësimet me shumë risqe marrin në konsideratë ndërvarësinë e disa rreziqeve dhe risqeve.

**Vlerësimi i cenueshmërisë dhe kapacitetit të bazuar në (VCA**) dhe **vlerësimi i rrezikut i bazuar në GIS** janë gjithashtu kërkesa të kësaj konsulence. Rezultatet e VCA dhe të Vlerësimit të Rrezikut do të shfrytëzohen mëtej në procesin e hartimit të Strategjisë për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe më pas në Planin Vendor të Emergjencës Civile.

Për nevojat e hartimit të planit vendor të emergjencave, informacioni i vlerësimit të riskut duhet të organizohet në një format të përdorshëm nga ekipi i planifikimit. Një metodë efektive

[5] Commission Staff Ëorking Paper - Risk Assessment and https://ëëë.eumonitor.nl/9353000/1/j9vvik7m1c3gyxp/vilsc7ikt7zq

për organizimin e informacionit të riskut ose kërcënimit është përdorimi i një matrice të bazuar në dimensionet e përdorura gjatë procesit të analizës së rrezikut:

• Probabiliteti ose shpeshtësia e shfaqjes

• Madhësia (forca fizike e lidhur me rrezikun ose kërcënimin)

• Intensiteti/ashpërsia (ndikimi ose dëmtimi i pritur)

• Koha e disponueshme për të paralajmëruar

• Vendndodhja e emergjencës (një zonë interesi ose një vend ose objekt i veçantë ose i papërcaktuar)

• Madhësia e mundshme e zonës së prekur

• Shpejtësia e fillimit (sa shpejt rreziku ose kërcënimi mund të ndikojë te publiku)

• Kohëzgjatja (sa kohë rreziku ose kërcënimi do të jetë aktiv)

• Efektet vijuese (efektet e goditjes, domino ose kaskadë)

Informacione të tjera nga VCA dhe vlerësimi i rrezikut që duhet të përgatiten dhe të vihen në dispozicion në mënyrë specifike për qëllime të planifikimit emergjent duhet të përmbajnë të paktën, por nuk duhet të kufizohen në:

• Objektet/vendet e pritjes për evakuim

• Objektet dhe/ose vendet e akomodimit emergjent

• Objektet/vendndodhjet për automjetet dhe makineritë e emergjencës

Rrugët e evakuimit në situata emergjente të shkaktuara nga:

• Tërmet

• Përmbytja

• Zjarri

Statistikat e personave me aftësi të kufizuara dhe grupeve vulnerabël.

Ofruesi i Shërbimeve duhet të punojë në bashkëpunim të ngushtë me Bashkinë Tiranë, Prefekturën Tiranë dhe stafin e AKMC-së në nivel qendror.

## 4.2 Strategjia Vendore e Zvogëlimit të Riskut të Fatkeqësive (SVZRF) dhe Plani i Veprimit

Strategjia dhe Plani i Veprimit për DRR-në komunale/lokale duhet të përputhen me Strategjinë Kombëtare të ZRRF-së dhe Planin e Veprimit të saj dhe në përputhje me Kuadrin

Sendai[6] dhe legjislacionin e BE-së. Strategjia lokale e ZRF-së është mjeti gjithëpërfshirës i planifikimit strategjik komunal që përcakton qëllimet dhe objektivat e përgjithshme në periudha të ndryshme kohore, duke marrë parasysh afatet afatshkurtra dhe afatmesme, duke përqafuar njëkohësisht një perspektivë afatgjatë. Ai synon parandalimin e risqeve të reja dhe reduktimin e risqeve ekzistuese, rimëkëmbjen nga rreziqet e ndodhura dhe forcimin e qëndrueshmërisë ekonomike, sociale, shëndetësore dhe mjedisore. Ai është ndërtuar mbi kontekstin lokal dhe profilin e rrezikut, duke përcaktuar qëllimet e përgjithshme, objektivat, parimet udhëzuese, prioritetet për veprim, kostot dhe afatin kohor përkatës.

Në procesin e zhvillimit të strategjisë, është e rëndësishme të merren parasysh dy elementë. Në radhë të parë, procesi i hartimit të strategjisë, ku vizioni i bashkisë dhe raporti i saj me risqet nga fatkeqësitë diskutohet dhe negociohet ndërmjet aktorëve të ndryshëm lokalë. Në radhë të dytë, vetë strategjia: produkti i prekshëm (dhe zakonisht i shkruar) që rezulton nga procesi i hartimit të strategjisë. Strategjia duhet të përcaktojë mënyrat për të inkorporuar reduktimin e riskut në mënyrë të përhershme dhe organike në planifikimin e zhvillimit.

Një proces me të vërtetë pjesëmarrës për zhvillimin e Strategjisë është po aq i rëndësishëm sa edhe rezultati - vetë Strategjia si produkt - pasi një proces i tillë ofron mundësinë për palët e interesuara vendore të ndërgjegjësohen dhe të përfshihen, dhe për këtë arsye të mësojnë, kuptojnë dhe bashkë-hartojnë Strategjinë lokale.

Përveçse është përcaktuar në mënyrë specifike në objektivin “E” të Kuadrit Sendai, formulimi i Strategjive lokale të ZRF është gjithashtu një nga kërkesat e Ligjit 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, i cili kërkon gjithashtu harmonizimin e strategjisë lokale me Strategjinë kombëtare e ZRF sa herë që kjo e fundit vihet në dispozicion.

Një plan veprimi ofron udhëzime operacionale për zbatimin e strategjisë dhe duhet të përmbajë masa kritike për një periudhë afatshkurtër dhe afatgjatë, duke kontribuar në realizimin e objektivave strategjike. Masat mund të jenë strukturore, d.m.th., që kërkojnë ndërhyrje dhe investim të drejtpërdrejtë në territor, ose jostrukturore, të cilat kërkojnë një qasje të butë dhe synojnë kryesisht ngritjen e kapaciteteve, ndërgjegjësimin e komunitetit, fushatat informuese, studimet e mëtejshme të thelluara, etj. shoqëruar me një vlerësim të afateve, treguesve, kostove dhe identifikimin e përgjegjësive përkatëse institucionale për zbatimin e tyre.

Strategjia duhet të përmbajë gjithashtu një kornizë të detajuar Monitorimi dhe Raportimi për të mundësuar ndjekjen adekuate të zbatimit. Monitorimi sugjerohet të ndahet në dy aspekte kryesore:

[6] Dhjetë elementët kryesorë që strategjitë e ZRF duhet të kenë për t'u lidhur me Kornizën Sendai mund të gjenden në "Strategjitë Lokale të Reduktimit të Rrezikut të Fatkeqësive dhe Rezistencës Fjalët në Veprim të Zyrës së OKB-së për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë"

• Monitorimi i strategjisë i cili duhet të bazohet në tregues konkretë të zhvilluar në kuadër të secilës masë.

• monitorimin e situatës së ZRF në bashki, e cila është e nevojshme për të parë efikasitetin dhe ndikimin e zbatimit të masave. Në këtë rast sugjerohet përdorimi/kontekstualizimi i treguesve globalë që matin progresin drejt arritjes së objektivave globale të kuadrit Sendai. Duke qenë se Shqipëria ka detyrimin të raportojë për arritjen e objektivave globale të Sendait, rekomandohet fuqimisht unifikimi i metodologjisë së përdorur në nivel kombëtar dhe lokal. Prandaj, AKMC do të ofrojë informacion të vazhdueshëm mbi aktivitetet dhe rezultatet e dokumenteve të vazhdueshme të nivelit kombëtar për ofruesin e shërbimit në mënyrë që të sigurojë harmonizimin e nevojshëm ndërmjet dokumenteve në dy nivele, përfshirë metodologjinë e monitorimit dhe raportimit Sendai.

## 5. METODOLOGJIA

Sekuenca e zbatimit do të respektojë skemën e mëposhtme:

**Vulnerabiliteti dhe Vlerësimi i Kapacitetit – Vlerësimi i Riskut – Strategjia Vendore**

**Ndërtim kapaciteteve**

**ZRF**

Ofruesi i Shërbimit do të jetë përgjegjës për zhvillimin e Vlerësimit të Vulnerabilitetit dhe Kapacitetit (VCA), Vlerësimit të Riskut (RA) dhe Strategjisë së ZRF dhe Planit të Veprimit të saj. Ofruesi i Shërbimeve do të udhëhiqet nga procesi kombëtar për përgatitjen e dokumenteve strategjike/planifikuese dhe do të përgatisë raportet e kërkuara në përputhje me dokumentin e përditësuar kombëtar të Vlerësimit të Riskut dhe Strategjinë Kombëtare të ZRF. Dokumentet e Vlerësimit Lokal të Riskut do të jenë në përputhje me metodologjitë kombëtare të aplikuara për secilin prej rreziqeve dhe të dhënat lokale do të mblidhen sipas strukturës së përditësuar të Vlerësimit Kombëtar të Riskut.

Në analogji me procesin kombëtar, grupet vendore të punës për përgatitjen e Vlerësimit të Riskut lokal dhe Strategjisë lokale të ZRF duhet të krijohen në bashkëpunim të ngushtë me AKMC, Prefekturën e Tiranes dhe të gjitha minibashkitë. Ofruesi i Shërbimit do të asistojë dhe mbështesë një proces të tillë duke ofruar rekomandimet dhe ekspertizën e nevojshme në nivel lokal për njësitë e qeverisjes vendore.
Zhvillimi i dokumenteve të ZRRF duhet të jetë pjesëmarrës dhe gjithëpërfshirës dhe të përfshijë palët e interesuara lokale dhe ekspertizën e nevojshme. Aspektet pjesëmarrëse dhe gjithëpërfshirëse kërkohen nga pikëpamja procedurale, por ato gjithashtu kontribuojnë në një proces të gjerë dhe gjithëpërfshirës të ndërtimit të kapaciteteve për palët e interesuara vendore. Në të njëjtën kohë, dokumentet nuk janë një qëllim në vetvete. Ata duhet të identifikojnë veprimet dhe masat dhe nivelet përkatëse përgjegjëse për zbatimin e tyre. Ofruesi i Shërbimeve duhet të ndërveprojë ngushtë edhe Komisionin e Mbrojtjes Civile në nivel qarku

dhe bashkie. Ky organ i përhershëm nëse nuk është krijuar deri më tani, do të jetë detyrë e Ofruesit të Shërbimeve të ndihmojë bashkine në përgatitjen e Urdhrit përkatës të Kryetarit dhe rregulloreve përkatëse në përputhje me Ligjin "Për mbrojtjen civile". Përveç institucioneve shtetërore (Prefekti, Qarku, njësitë administrative, mbrojtja civile, Policia e Shtetit, ushtria, zjarrfikësja, shëndetësia, mjedisi, arsimi, urbanistika, turizmi, trashëgimia kulturore, bujqësia, vaditja dhe kullimi, ujësjellës-kanalizimet, energjia, etj. komunikimi, transporti, mbrojtja sociale, financat, çështjet ligjore, burimet njerëzore, struktura e marrëdhënieve ndërkombëtare/integrimit evropian, sporti) këshillohet fuqimisht që KMC të përfshijë palë të tjera të interesuara joqeveritare si:

- Kryqi i Kuq,
- OJQ, OSHC,
- Bizneset,
- Akademi,
- Media,
- Klerikë
- Organizatat Ndërkombëtare.

Struktura e Emergjencave Civile/Mbrojtjes Civile në bashki[7] do të luajë rolin e Sekretarit Teknik të Komisionit të Mbrojtjes Civile.

Gjatë zbatimit, qasjet e përdorura duhet të marrin parasysh gjithashtu:

- rreziqet që lidhen me ndryshimet klimatike
- mundësitë dhe mekanizmat për përfshirjen e ZRF në planet e zhvillimit lokal
- çështjet e barazisë gjinore dhe përfshirjes sociale

Për sa i përket specifikave të secilit prej produkteve kryesore, Ofruesi i Shërbimit duhet të shënojë kërkesat/ rekomandimet e mëposhtme:

**Vlerësimi i Vulnerabilitetit dhe Kapacitetit (VCA)** duhet të jetë në përputhje me paketën VCA të Federatës Ndërkombëtare të Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe (IFRC)[8], pasi ai model VCA ofron një gamë të gjerë mjetesh dhe metodash dhe është pilotuar gjerësisht dhe përdoret në shumë vende në zhvillim dhe të zhvilluara dhe ka rezultuar i suksesshëm edhe në pilotimin e Fierit.

**Vlerësimi i Riskut** do të bazohet në dokumentin Dokumenti i Punës së Stafit të Komisionit SEC (2010) 1626 përfundimtar, Udhëzimet për Vlerësimin e Rrezikut dhe Hartëzimin për Menaxhimin e Fatkeqësive, Udhëzues fjalësh në Veprim Vlerësimi Kombëtar i Rrezikut të Fatkeqësive UNISDR 2017, Direktiva INSPIRE, ISO 3100, ISO 33100 terminologjinë përkatëse ISO Guide 73, në kombinim me terminologjinë më të synuar të UNISDR për

---

[7] Në zbatim të VKM nr. 923, datë 25.11.2020 "Për funksionimin dhe organizimin e komitetit të mbrojtjes civile dhe bashkëpunimin ndërinstitucional të institucioneve dhe strukturave të mbrojtjes civile", këto struktura janë përcaktuar si "struktura të përhershme të planifikimit dhe mbrojtjes civile".
[8] https://ëëë.ifrc.org/Global/Publications/disasters/vca/vca-toolbox-en.pdf

reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë, dhe praktikat e UNDRR të përshtatura me këto udhëzime.

Strategjia lokale për Reduktimin e Riskut të Fatkeqësive duhet të përafrohet me Strategjinë Kombëtare të ZRRF dhe SFDRR 2015-2030. Duke u mbështetur në 10 elementët kryesorë të mëposhtëm duhet të mbulohen nga strategjitë e ZRF-së në mënyrë që të konsiderohen në përputhje me Kuadrin Sendai[9]:

1. Të kene shkallë të ndryshme kohore, me objektiva, tregues dhe korniza kohore.
2. Synojnë parandalimin e krijimit të riskut.
3. Synoni në reduktimin e riskut ekzistues.
4. Synimi në forcimin e qëndrueshmërisë ekonomike, sociale, shëndetësore dhe mjedisore.
5. Adresoni rekomandimet e Prioritetit 1 të SFZRF: Kuptimi i riskut nga fatkeqësitë, bazuar në njohuritë dhe vlerësimet e rrezikut për të identifikuar rreziqet në nivelet lokale dhe kombëtare të kapaciteteve teknike, financiare dhe administrative të menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë.
6. Adresoni rekomandimet e Prioritetit 2 të SFZRF: Forcimi i qeverisjes së rrezikut nga fatkeqësitë për të menaxhuar rrezikun nga fatkeqësitë. Përfshirja dhe integrimi i ZRF brenda dhe në të gjithë sektorët me role dhe përgjegjësi përcaktuese.
7. Adresoni rekomandimet e Prioritetit 3 të SFZRF: Investimi në reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë për elasticitetin, i cili drejton shpërndarjen e burimeve të nevojshme në të gjitha nivelet e administratës për zhvillimin dhe zbatimin e strategjive të ZRF në të gjithë sektorët përkatës.
8. Adresoni rekomandimet e Prioritetit 4 të SFZRF: Rritja e gatishmërisë ndaj fatkeqësive për reagim efektiv dhe për të "ndërtuar më mirë" në rikuperim, rehabilitim dhe rindërtim. Forconi gatishmërinë ndaj katastrofave për reagim dhe integroni masat e gatishmërisë për reagim ndaj ZRF dhe zhvillimit për t'i bërë kombet dhe komunitetet elastike ndaj fatkeqësive.
9. Promovoni koherencën e politikave të rëndësishme për reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë, si zhvillimi i qëndrueshëm, çrrënjosja e varfërisë dhe ndryshimet klimatike, veçanërisht me SDGs dhe Marrëveshjen e Parisit.
10. Të ketë mekanizma për të ndjekur, vlerësuar periodikisht dhe raportuar publikisht për progresin.

Në lidhje me metodologjinë e monitorimit Sendai, rekomandohet fuqimisht referenca tek “Udhëzuesi Teknik për Monitorimin dhe Raportimin mbi Progresin në Arritjen e Objektivave Globale të Kornizës Sendai për Reduktimin e Rrezikut nga Fatkeqësitë”.

Gjithsesi, dokumenti i përditësuar i Vlerësimit Kombëtar të Riskut dhe Strategjia Kombëtare e ZRF-së dhe Plani i saj i Veprimit do të përbëjnë dokumentet e referencës parësore si dhe dokumentin strategjik/planifikues lokal të pilotuar në bashkinë e Fierit.

[9] Ëords into Action guidelines: Implementation guide for local disaster risk reduction and resilience strategies https://ëëë.undrr.org/publication/ëords-action-guidelines-implementation-guide-local-disaster-risk-reduction-and

Ofertuesi mund të konsultojë grupin e dokumenteve të ZRF-së të gjashtë bashkive të Qarkut Fier.

## 6. TERMAT KOHORE DHE PRODUKTET FINALE

Rezultatet e mëposhtme priten për bashkinë:

1. Ngritja dhe mobilizimi i grupeve të punës
2. VCA dhe Vlerësimi Lokal i Riskut të Fatkeqësive (VLRF)
3. Strategjia Vendore për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive dhe Plani i Veprimit

Kohëzgjatjet e mëposhtme janë parashikuar:

- Mobilizimi dhe përgatitja – jo më shumë shumë se 2 muaj nga nënshkrimi i kontratës
- VCA dhe VLRF – jo më shumë shumë se 6 muaj
- Strategjia Vendore e ZRF – jo më shumë shumë se 4 muaj

Strategjia duhet të fillojë të paktën 2 muaj përpara përfundimit të detyrës së vlerësimit të riskut; prandaj, kohëzgjatja totale e të dy fazave vlerësohet të zgjasë jo më shumë se 12 muaj. Këto vlerësime përfshijnë gjithashtu kohën e nevojshme për rishikimin e rezultateve dhe miratimet nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile. Gjuha e punës e detyrës do të jetë shqipja. Ofruesi i Shërbimit pritet të dorëzojë të gjitha dokumentat në mënyrë elektronike dhe të printuara në gjuhën shqipe, duke u siguruar që ato të jenë plotësisht të redaktuara dhe pa gabime gramatikore.

Ofruesi i Shërbimeve do të ketë takime progresi me stafin e bashkisë gjate analizave, stafin e AKMC-së në të dy nivelet dhe partnerët e tjerë kyç për të siguruar zbatimin e saktë dhe të suksesshëm të konsulencës së kërkuar.

Të gjitha dokumentet e kërkuara duhet të miratohen nga njësitë e qeverisjes vendore (miratohet nga Këshilli Bashkiak) dhe AKMC.

## 7. QEVERISJA DHE PËRGJEGJËSIA

## 7.1 Autoriteti Mbikëqyrës

Ofruesi i Shërbimit do të punojë nën mbikëqyrjen e përgjithshme të Bashkisë Tirane, tek e cila Ofruesi i Shërbimit do të raportojë drejtpërdrejtë, do të kërkojë miratimin dhe do të marrë pranimin e produkteve. Nga ana tjetër është detyrimi i Bashkisë Tiranë të raportojë periodikisht (1 herë në muaj) mbi progresin e zbatimit në AKMC.

Duhet pasur parasysh se në bazë të ligjit 45/2019:

• Bashkia është e detyruar t'i dërgojë AKMC-së dhe Prefektit Vlerësimin e Riskut për qëllime analize dhe planifikimi.

• Prefekti ka një rol parësor në reduktimin e rrezikut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile në nivel qarku.

• Nuk ka strategji të ZRF në nivel qarku.

• Strategjia vendore e ZRF duhet të harmonizohet me Strategjinë Kombëtare të ZRF

## 7.2 Bashkëpunimi ndërinstitucional

Gjatë përgatitjes së dokumenteve, Ofruesi i Shërbimit do të bashkëpunojë ngushtë me bashkinë dhe minibashkitë, AKMC, Prefekturën e Tiranës, drejtoritë apo agjencitë rajonale. Ofruesi i Shërbimeve duhet të bashkëpunojë veçanërisht me Komisionin e Mbrojtjes Civile në nivel bashkie për të marrë mbështetjen dhe miratimet e nevojshme në procesin e zbatimit të aktiviteteve të projektit. Komisioni i Mbrojtjes Civile do të jetë në grup pune për vlerësimin e riskut dhe strategjinë e ZRF. Komisioni i Mbrojtjes Civile do të ofrojë qasje në të dhënat dhe informacionet ekzistuese në lidhje me fushëveprimin e kërkuar të punës dhe do ta mbështesë atë për realizimin e suksesshëm të detyrës. Bashkia, e mbështetur nga Prefekti do të sigurojë çdo akses tjetër në të dhënat dhe informacionet e tjera në lidhje me qëllimin e kërkuar të punës, do të krijojë marrëdhënie me institucionet vendore dhe qendrore kur është e nevojshme, si dhe do të ofrojë të gjithë mbështetjen e nevojshme për realizimin me sukses të detyrës.

## 7.3 Raportimi menyra e pageses

Në mënyrë më të detajuar grafiku i pagesave lidhet me dorezimin e raporteve si më poshtë:

1. Raporti fillestar dhe ngritja e grupeve te punes - 10 % e vleres se kontrates
2. Analiza e politikave, kornizave institucionale, ligjore dhe menaxhuese kundrejt procesit për ZRF - 20 % e vleres se kontrates;
3. Draft Raporti per VCA dhe Vlerësimi Lokal i Riskut të Fatkeqësive (VLRF) - 20 % e vleres se kontrates;
4. **Raporti final per VCA dhe Vlerësimi Lokal i Riskut të Fatkeqësive (VLRF)** - 5 % e vleres se kontrates;
5. Raport mbi aktivitetet konsultative me grupet e interesit dhe komunitetin - 5 % e vleres se kontrates;

6. Draft Strategjia vendore për ZRF dhe Plani i Veprimit - 30 % e vleres se kontrates;
7. **Versioni final i Strategjisë vendore për ZRF dhe Plani i Veprimit** - 10 % e vleres se kontrates

## 8. KOHËZGJATJA E IMPLEMENTIMIT

Periudha e zbatimit të detyrës do të jetë jo më shumë se 12 muaj, kryerja e VCA dhe VLRF - maksimumi 8 muaj, Strategjia e ZRF - maksimumi 4 muaj.
Ofruesit të Shërbimeve do t'i kërkohet të zbatojë detyrat e planifikuara sipas afateve kohore të treguara në planin e pagesave.

## 9. KUALIFIKIMET E OFRUESIT TË SHËRBIMIT

### 9.1 Profili i Ofruesit të Shërbimit

1. Të paktën tre referenca/kontrata ku janë ofruar shërbime të ngjashme qe lidhen me menaxhimin apo zvogelimin e riskut te fatkeqesive, mjedisin, ndryshimet klimatike, hartimin e dokumentave strategjike dhe/ose planeve te veprimit, zhvillimin social dhe ekonomik ne nivel lokal, rajonal apo kombëtar, zhvillimin urban.
2. Pervoje (të paktën një reference/kontratë) në kryerjen e programeve të trajnimit dhe fushatave ndërgjegjësuese në nivel kombëtar dhe lokal;

3. Staf dhe ekspertizë e përshtatshme për të mbledhur dhe interpretuar të dhëna dhe informacion, për të zhvilluar analiza dhe raporte me fokus të veçantë në vlerësimet e risqeve;
4. Përvojë e mëparshme pune me agjenci të financuara nga donatorë.

### 9.2 Personeli i Ofruesit të Shërbimit

Ofruesi i Shërbimit duhet të vërë në dispozicion një ekip ekspertësh me përvojë dhe kualifikim të lartë dhe të ketë burime të mjaftueshme për të ofruar shërbimin me efektivitet, efikasitet, cilësi dhe profesionalizëm. Duke marrë parasysh numrin e bashkive në fushëveprimin e kësaj detyre, vëllimin e punës dhe kohëzgjatjen e kufizuar të zbatimit, ekipi i ekspertëve duhet të përbëhet nga një numër i duhur i profesionistëve me përvojë adekuate dhe kualifikime profesionale për detyrën siç është përcaktuar më poshtë.

Profilet e ekspertëve duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

| POZICIONI | EDUKIMI DHE AFTËSITË | EKSPERIENCË PUNE |
|---|---|---|
| ***Udhëheqës Ekipi*** | • Diplome universitare ne | • Të ketë përvojë të demonstruar |

| | | |
|---|---|---|
| Përgjegjës për koordinimin e përgjithshëm dhe kontrollin e cilësisë së produkteve të dorëzuara. Ajo/Ai pritet të ofrojë udhëzime dhe udhëheqje për ekipin e ekspertëve me qëllim të arritjes së detyrave të caktuara. Udhëheqësi i Ekipit do të jetë gjithashtu përgjegjës për dorëzimin përfundimtar të produkteve dhe do të veprojë si përfaqësuesi kryesor me bashkinë dhe AKMC-në. | nivelin master ne Inxhinieri, Shkenca Mjedisore, Ekonomik, Shkenca te Natyres ose fusha te ngjashme, me trajnime ne fushen e<br><br>Menaxhim të Riskut të Fatkeqësive ose të ngjashme dhe/ose disiplinat e qendrushemërisë ndaj klimës ose lëndë të tjera të ngjashme.<br>• Aftësi të shkëlqyera menaxheriale dhe koordinuese<br>• Aftësi të shkëlqyera analitike | në menaxhimin kompleks të punës për Menaxhimin e Riskut të Fatkeqësive në një rol udhëheqës<br>• Preferohet përvoja e punës në ZRF, duke përfshirë hartimin dhe zbatimin e projekteve përkatëse në nivel kombëtar/lokal<br>• Aftësi të forta teknike në MRF, zhvillimin dhe përdorimin e mjeteve të vlerësimit të riskut dhe/ose rrezikut dhe vlerësimet e ndikimit për vendimmarrjen e bazuar në prova, qasjet e qeverisjes së riskut dhe zhvillimin e kapaciteteve MRF<br>• Njohuri dhe të kuptuarit e çështjeve të së shkuarës dhe atyre bashkëkohore të MRF me të cilat përballet Shqipëria<br>• Përvojë në mbështetjen efektive të çështjeve dhe zgjidhjeve për MRF në disa nivele, duke përfshirë konsolidimin e mbështetjes së partnerëve të zhvillimit dhe palëve të interesuara<br>• Të kuptuarin dhe njohjen me përgjigjen ndaj fatkeqësive dhe koordinimin e rimëkëmbjes në rajon<br>• Aftësi udhëheqëse, duke përfshirë koordinimin dhe udhëzimin e stafit<br>• Aftësi për të hartuar, menaxhuar dhe zbatuar |

| | | |
|---|---|---|
| | | programe komplekse të asistencës zhvillimore në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal<br>• Përvojë në menaxhim projekti duke përfshirë të kuptuarit e parimeve të ciklit të projektit, kuadrit logjik, monitorimit dhe vlerësimit<br>• Kapacitet dhe aftësi efektive ndërvepruese për të zhvilluar dhe mbajtur marrëdhënie të forta pune me homologët kombëtarë dhe partnerët rajonalë |
| **A. Vlerësimi i Cenueshmërisë dhe i Kapaciteteve dhe Vlerësimi i Riskut në Nivel Lokal** | | |
| **Ekspert i Vlerësimit të Riskut për rreziqet e Sëmundjeve Infektive (Biologjike)** | Diplomë pasuniversitare në biologji, mikrobiologji, inxhinieri biologjike dhe/ose çdo fushë e përshtatshme studimi | • Të ketë përvojë profesionale në fushën e shëndetit publik<br>• Demonstruar ekspertizë teknike të dalluar, e përshtatshme për detyrat përkatëse<br>• Preferohen përvoja pune të lidhura drejpërdrejt me aktivitete të menaxhimit të fatkeqësive të rreziqeve biologjike në nivel rajonal |
| **Ekspert i Vlerësimit të Riskut të Përmbytjeve** | Diplomë pasuniversitare në inxhinieri hidrologjike dhe hidraulike, meteorologji, ose çdo fushë tjetër e përshtatshme studimi | • Të ketë përvojë në fushën e vlerësimit të riskut nga përmbytjet dhe menaxhimit të ujit<br>• Demonstruar ekspertizë teknike të dalluar, e përshtatshme për detyrat përkatëse |

| | | |
|---|---|---|
| | | • Preferohen përvoja pune të lidhura drejtpërdrejt me aktivitete të menaxhimit të fatkeqësisë së përmbytjes në nivel rajonal |
| **Ekspert i Vlerësimit të Riskut Sizmik dhe i Vlerësimit të Rrëshqitjeve të Dheut** | Diplomë pasuniversitare në tërmete/inxhinieri ndërtimi, sizmologji, inxhinieri gjeoteknike ose disiplina të tjera të lidhura | • Të ketë përvojë profesionale në studimet sizmik, duke përfshirë rrëshqitjet e dheut<br>• Preferohen përvoja pune të lidhura drejtpërdrejt me vlerësime sizmike dhe të rrëshqitjeve të tokës në nivel rajonal |
| **Ekspert i Vlerësimit të Riskut Teknologjik (Industrial)** | Diplomë pasuniversitare në inxhinieri kimike, inxhinieri bioteknologjie, inxhinieri biokimike dhe/ose çdo fushë e përshtatshme studimi | • Të ketë përvojë profesionale në sektorin industrial dhe teknologjik<br>• Demonstruar ekspertizë teknike të dalluar, e përshtatshme për detyrat përkatëse<br>• Preferohen përvoja pune të lidhura drejtpërdrejt me aktivitete të menaxhimit të rreziqeve teknologjike në nivel rajonal |
| **Ekspert i Vlerësimit të Riskut të Zjarreve në Pyje** | Diplomë pasuniversitare në ekologji pyjore, menaxhim pyjesh, mjedis ose çdo fushë tjetër e përshtatshme studimi | • Të ketë përvojë në fushën e Pylltarisë dhe menaxhimit të zjarreve në pyje.<br>• Përvojë dhe njohuri e mirë e kontekstit rajonal të zjarreve në pyje, risqeve të ndryshimeve klimatike<br>• Preferohen përvoja pune të lidhura drejtpërdrejt me aktivitete të menaxhimit të zjarreve në pyje në nivel |

| | | |
|---|---|---|
| | | rajonal |
| **2 Ekspert GIS** | Diplomë pasuniversitar në Gjeodezi, apo çdo fushë tjetër të përshtatshme.<br>Aftësi analitike të shkëlqyera. | • Të ketë përvojë pune në GIS dhe aplikimin në harta dhe vlerësime të ndryshme, duke përfshirë gjithashtu, mundësisht, rreziqet natyrore. |
| **B. Strategja Lokale ZRF dhe Plani i Veprimit** | | |
| **Ekspert i ZRF** | Diplomë universitare në nivelin master ne Inxhinieri, Shkenca Mjedisore, Shkenca natyrore, Menaxhim të Riskut të Fatkeqësive ose fusha të ngjashme | - Të ketë përvojë në ZRF, menaxhimin e krizave, sistemet e paralajmërimit të hershëm, mekanizmat e gatishmërisë dhe përgjigjes, komunikimet emergjente, mbrojtjen civile ose ndonjë kombinim ekuivalent/i aplikueshëm trajnimi dhe përvoje |
| **Ekspert Inxhinierie Ndërtimi dhe i Zhvillimit Urban/Territorial** | Diplomë pasuniversitare në Inxhinieri Ndërtimi dhe/ose zhvillimin urban.<br>Aftësi analitike të shkëlqyera. | - Të ketë përvojë pune në zhvillimin e punimeve civile lokale, sigurinë dhe standardet e ndërtesave, planifikimin urban dhe rajonal duke përfshirë planifikimin e përdorimit të tokës, analizën socio-ekonomike, planifikimin e infrastrukturës dhe mjedisit, politikat e strehimit dhe iniciativat zhvillimore, pjesëmarrjen e palëve të interesuara dhe ngritjen e kapacitetit institucional<br>- Preferohet përvojë pune në ZRF |
| **Ekspert i Zhvillimit Lokal Social dhe Ekonomik** | Diplomë pasuniversitare në | - Të ketë përvojë pune në zhvillimin ekonomik lokal, |

| | | |
|---|---|---|
| | Ekonomiks, Zhvillim, Administratë Publike, ose çdo fushë tjetër të përshtatshme.<br>Aftësi analitike të shkëlqyera. | analiza dhe identifikim të vlerave lokale, nxitësit dhe mundësitë ekonomike, potencialet zhvillimore dhe kapaciteteve lokale, zgjerimin e mundësive në mënyrë që prej rritjes dhe zhvillimit të përfitojnë grupet e marxhinalizuara<br>- Përvojë pune në ZRF |
| **Ekspert i Pushtetit Vendor** | Diplomë pasuniversitare në Shkencat e Zhvillimit, Administratë Publike, ose çdo fushë apo disiplinë tjetër të përshtatshme | - Të ketë përvojë pune me pushtetin vendor në fushën e ngritjes së kapaciteteve institucionale, menaxhimit të ndryshimeve, menaxhimit financiar, apo të ngjashme. |
| **Ekspert Financiar** | Diplomë pasuniversitare në finance, qeverisjen dhe zhvillimin ekonomik, politika publike ose tjetër diplomë e përshtatshme | - Të ketë përvojë pune dhe kompetencë e dëshmuar në kryerjen e kërkimit dhe ofrimin e udhëzimeve strategjike në fushën e shpërndarjes së fondeve dhe shpenzimeve publike dhe përvojë në lidhje me shpërndarjet e fondeve publike dhe shpenzimet për aftësi ripërtëritëse.<br>- Preferohet përvojë e dëshmuar në analiza ekonomike, financa publike dhe investime për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë |
| **Ekspert i Mjedisit dhe Ndryshimeve Klimatike** | Diplomë pasuniversitare në Shkenca Mjedisi ose çdo fushë apo disiplinë tjetër e përshtatshme | - Të ketë përvojë pune në fushën e mjedisit, ndryshimeve klimatike, zvogëlimit dhe menaxhimit |

| | | |
|---|---|---|
| | | të riskut nga fatkeqësitë |

Vendi dhe dorëzimi i shërbimeve: **Bashkia Tirane**

**Shtojca 11**

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

**FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

1. **KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;

ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;

d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;

dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;

e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;

gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 12.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet:

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit[10].

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

[10] Në këtë marrëveshje nuk duhet të përcaktohet përqindja e sherbimeve të secilit anëtar, por fushat/ekpertizat e marra përsipër për tu realizuar.

**2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12*

*b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5;*

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. Sipas pikes 1 te shtojces 11 (Kriteret e Pergjithshme per Kualifikim).

**2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

**2.2.1.**Operatori Ekonomike duhet të paraqesë kopje të çertifikuara të bilanceve pozitive të 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (**2020, 2021, 2022)** *të konfirmuara nga autoritetet përkatëse, ne te cilat duhet te rezultoje se nuk ka dale me humbje te pakten ne dy vite te njepasnjeshem.* Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese*.

Shënim: *Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga O.E vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël,* ***për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm****: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.*

**2.2.2.** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30% të vlerës së parashikuar të kontratës objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

### 2.3 Kapaciteti teknik:

Shërbime të ngjashme të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, me vlerë jo më të vogël se 30 % e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.

a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur kontratën përkatëse, vërtetim për realizimin e plotë dhe te suksesshëm të kesaj kontrate.

b) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatese, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

*Në rastin e procedurave të prokurimit “Shërbim konsulence”, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit.*

**2.3.2** Operatori ekonomik duhet të dëshmojë se disponon “ekspertët kryesorë” per realizmin e këtij shërbimi si më poshtë vijon:

Për të vërtetuar këtë, OE duhet të paraqesë: listën emërore te ekspertëve kryesorë, kontratën e punës ose marrëveshjen e angazhimit për këtë procedurë të prokurimit, CV-të, dhe diplomat universitare përkatëse si pjesë e ofertës teknike.

Stafi që duhet të disponojë kontraktori duhet të ketë në përbërje specialistë të profileve si më poshtë:

**Udhëheqës Ekipi**

- Diplome universitare ne nivelin master ne Inxhinieri/Shkenca Mjedisore/Ekonomik/Shkenca te Natyres ose fusha te ngjashme, me trajnime ne fushen e Menaxhim të Riskut të Fatkeqësive ose të ngjashme dhe/ose disiplinat e qendrushemërisë ndaj klimës ose lëndë të tjera të ngjashme.
- Të ketë përvojë të demonstruar në menaxhimin kompleks të punës për Menaxhimin e Riskut të Fatkeqësive në një rol udhëheqës

**Ekspert i Vlerësimit të Riskut për rreziqet e Sëmundjeve Infektive (Biologjike)**

- Diplome universitare ne nivelin master në biologji/mikrobiologji/inxhinieri biologjike dhe/ose çdo fushë e përshtatshme studimi
- Të ketë përvojë profesionale në fushën e shëndetit publik

**Expert i Vlerësimit të Riskut të Përmbytjeve**

- Diplome universitare ne nivelin master në inxhinieri hidrologjike/hidrroteknikë/ meteorologji, ose çdo fushë tjetër e përshtatshme studimi
- Të ketë përvojë profesionale në fushën e vlerësimit të riskut nga përmbytjet dhe menaxhimit të ujit

**Expert i Vlerësimit të Riskut Sizmik dhe i Vlerësimit të Rrëshqitjeve të Dheut**

- Diplome universitare ne nivelin master në inxhinieri ndërtimi/sizmologji/inxhinieri gjeoteknike ose disiplina të tjera të ngjashme me to
- Të ketë përvojë profesionale në studimet sizmike, duke përfshirë rrëshqitjet e dheut

**Expert i Vlerësimit të Riskut Teknologjik (Industrial)**

- Diplome universitare ne nivelin master në inxhinieri kimike/inxhinieri bioteknologjie/inxhinieri biokimike dhe/ose çdo fushë e përshtatshme studimi
- Të ketë përvojë profesionale në sektorin industrial dhe teknologjik

**Expert i Vlerësimit të Riskut të Zjarreve në Pyje**

- Diplome universitare ne nivelin master në ekologji pyjore/menaxhim pyjesh/mjedis ose çdo fushë tjetër e përshtatshme studimi
- Të ketë përvojë profesionale në fushën e Pylltarisë dhe menaxhimit të zjarreve në pyje

**2 Expert GIS**

- Diplome universitare ne nivelin master në Gjeodezi
- Të ketë përvojë pune në GIS dhe aplikimin në harta dhe vlerësime të ndryshme, duke përfshirë gjithashtu, mundësisht, rreziqet natyrore

**Ekspert i ZRF**

- Diplomë universitare në nivelin master ne Inxhinieri/Shkenca Mjedisore/Shkenca natyrore/Menaxhim të Riskut të Fatkeqësive ose fusha të ngjashme

- Të ketë përvojë profesionale në ZRF, menaxhimin e krizave, sistemet e paralajmërimit të hershëm, mekanizmat e gatishmërisë dhe përgjigjes, komunikimet emergjente, mbrojtjen civile ose ndonjë kombinim ekuivalent/i aplikueshëm trajnimi dhe përvoje

**Ekspert Inxhinierie Ndërtimi dhe i Zhvillimit Urban/Territorial/**

- Diplome universitare ne nivelin master ne Inxhinieri/Shkenca Mjedisore/Shkenca natyrore/Menaxhim të Riskut të Fatkeqësive ose fusha të ngjashme
- Të ketë përvojë në ZRF, menaxhimin e krizave, sistemet e paralajmërimit të hershëm, mekanizmat e gatishmërisë dhe përgjigjes, komunikimet emergjente, mbrojtjen civile ose ndonjë kombinim ekuivalent/i aplikueshëm trajnimi dhe përvoje

**Ekspert i Zhvillimit Lokal Social dhe Ekonomik**

- Diplome universitare ne nivelin master në Ekonomiks/Zhvillim/Administratë Publike, ose çdo fushë tjetër të përshtatshme
- Të ketë përvojë pune në zhvillimin ekonomik lokal, analiza dhe identifikim të vlerave lokale, nxitësit dhe mundësitë ekonomike, potencialet zhvillimore dhe kapaciteteve lokale, zgjerimin e mundësive në mënyrë që prej rritjes dhe zhvillimit të përfitojnë grupet e marxhinalizuara

**Ekspert i Pushtetit Vendor**

- Diplome universitare ne nivelin master në Shkencat e Zhvillimit/Administratë Publike, ose çdo fushë apo disiplinë tjetër të përshtatshme
- Të ketë përvojë pune me pushtetin vendor në fushën e ngritjes së kapaciteteve institucionale, menaxhimit të ndryshimeve, menaxhimit financiar, apo të ngjashme

**Ekspert Financiar**

- Diplome universitare ne nivelin master në finance/ qeverisjen dhe zhvillimin ekonomik, politika publike ose tjetër diplomë e përshtatshme
- Të ketë përvojë pune dhe kompetencë e dëshmuar në kryerjen e kërkimit dhe ofrimin e udhëzimeve strategjike në fushën e shpërndarjes së fondeve dhe shpenzimeve publike si dhe përvojë në lidhje me shpërndarjet e fondeve publike dhe shpenzimet për aftësi ripërtëritëse.

- Preferohet përvojë e dëshmuar në analiza ekonomike, financa publike dhe investime për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë

**Ekspert i Mjedisit dhe Ndryshimeve Klimatike**

- Diplome universitare ne nivelin master në Shkenca Mjedisi ose çdo fushë apo disiplinë tjetër e përshtatshme
- Të ketë përvojë pune në fushën e mjedisit, ndryshimeve klimatike, zvogëlimit dhe menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë

**Shënim:** *Kriteri 2.3.2 dhe nënpikat e tij do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 12, pjesa III, pika B të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën nga OE i kualifikuar në vend të parë përpara publikimit të njoftimit paraprak të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.*

**- Dokumentacioni provues, i kërkuar në pikën 2.3.2 ( Stafi ) duhet të ngarkohet nga OE, si pjese e ofertes teknike për efekt të vlerësimit me pikë në fazën e dytë atë të paraqitjes së propozimeve teknike dhe ekonomike.**

**Një ekspert nuk duhet të jetë i angazhuar njëkohësisht në stafin e dy shoqërive që marrin pjesë në këtë procedurë prokurimi.**

***Shënim:*** *OE duhet të mbajnë në konsideratë përcaktimet ligjore, referuar Nenit 26, pika 1, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se, “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, ku parashikohet që, “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.”.*

*Mosparaqitja e dokumentacionit provues, do të jetë kusht s’kualifikimi.*

*Autoriteti Kontraktor do të bëjë verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetedeklarimin e bërë gjatë fazës së ofertimit. Konstatimi i mosperputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përbën kusht s'kualifikimi.*

**Në rastet e bashkimit të konsulentëve, kriteret e veçanta të kualifikimit plotësohen bashkarisht nga i gjithë bashkimi.**

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Shtojca 12**

**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I.Unë i nënshkruari _______________ në cilësinë e _________________ të operatorit ekonomik ______________________ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

| **Identifikimi** | **Përgjigjja** |
|---|---|
| Emri i operatorit ekonomik:<br>(Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE | ----------------------------------------------- |
| Numri NIPT/et: | --------------------------------------------------- |
| Adresa postare:<br>Qyteti / qyteti; Kodi postar | ------------------------------------------------------ |
| Përfaqësuesi (emri): | -------------------------------------------- |

| | |
|---|---|
| Telefoni: | ----------------------------------------------------- |
| E-mail: | ---------------------------------------------------------- |

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme).**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

| **Emri i nënkontraktorit të propozuar** | **NIPT –i** | **Përqindja e nënkontraktimit** | **Shërbimet për t’u nënkontraktuar** |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

- **Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

| **Emri (at) e subjekteve** | **NIPT-i** | **Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik** | **Specifiko konkretisht kapacitetin/et** |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

**Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit**

**A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT**

| **Deklarata** |
|---|

| |
|---|
| Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.<br>*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme* ______________________________________________ |
